



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2023:280825  
Datë: 18.06.2024  
Numri i dokumentit: 05828338

C.nr.2942/23

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtarja Erlinda Elezi-Tosku, me bashkëpunëtoren profesionale Bionda Rexhepi, në çështjen juridike kontestimore të paditësve M.H., B.G-R. dhe H.H., të tre nga Gjilani, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson A.B., avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Gjilanit-Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti kompensimi i diferencës në pagë dhe inflacion, vlera e kontestit 3,964.59 euro, jashtë seancës, me datë 13.06.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditësve M.H., B.G-R. dhe H.H., të tre nga Gjilani, dhe DETYROHET e paditura Komuna e Gjilanit-Drejtoria Komunale e Arsimit që:

Paditëses M.H. për periudhën 01.04.2021 – 31.08.2021, në emër të diferencës në pagë për shkak të kualifikimit, duke llogaritur nga 55.35 euro në muaj, për gjithsej 4 muaj, t'ia paguaj shumën prej 221.4 euro; dhe në emër të inflacionit sipas shkallës së inflacionit për këto muaj, t'ia paguaj shumën prej 57.25 euro; apo shumën e përgjithshme prej 278.65 euro;

Paditëses B.G-R. për periudhën kohore 01.12.2020 – 31.12.2020, t'ia paguaj shkallën e inflacionit në shumën prej 0.84 euro;

Paditësit H.H. për periudhën kohore 18.01.2021 – 15.05.2021, t'ia paguaj shkallën e inflacionit në shumën prej 71.57 euro;

Të gjitha, me kamatë ligjore prej 8 % nga data 12.12.2023 si datë e paraqitjes së padisë, e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

II. REFUZOHET e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësve, edhe atë paditëses M.H. e kërkuar për periudhën 31.08.2021 – 06.02.2023 për kualifikim dhe tetor 2021 dhe 2022 për inflacion; paditëses B.G-R. për periudhën 04.07.2022 – 06.02.2023 për kualifikim dhe 2020, 2021 dhe 2022 për inflacion; paditësit H.H. për periudhën 2020, qershor 2021 dhe 2022 për inflacion, si periudhë gjatë së cilës paditësit nuk kanë qenë të punësuar te e paditura, në shumën e përgjithshme prej 3,613.35 euro.

### III. Secila palë i bart shpenzimet e veta të procedurës.

#### A r s y e t i m

Paditësit, përmes të autorizuarit të tyre, më datë 12.12.2023 ka paraqitur padi në këtë gjykatë kundër të paditurës për kompensimin e diferencës në pagë dhe inflacionit.

Në padi kanë theksuar se janë të punësuar te e paditura, ndërsa asnjëherë nuk është kompensuar nga e paditura për diferencën në pagë për shkak të kualifikimit/licencimit dhe përqindjes sipas inflacionit, përkundër që kjo e drejtë i takon sipas vendimit të qeverisë dhe kontratave kolektive. Për paditësen M.H. ka kërkuar kompensimin e kualifikimit për periudhën kohore 01.04.2021 – 06.02.2023 në shumën prej 1,162.35 euro dhe kompensimin e inflacionit për periudhën kohore 2021 dhe 2022 në shumën prej 774.94 euro; për paditësen B.G-R. ka kërkuar kompensimin e kualifikimit për periudhën kohore 04.07.2022 – 06.02.2023 në shumën prej 387.45 euro dhe kompensimin e inflacionit për periudhën kohore 2020, 2021 dhe 2022 në shumën prej 772.42 euro; dhe për paditësin H.H. ka kërkuar kompensimin e inflacionit për periudhën kohore 2020, 2021 dhe 2022, në shumën prej 867.43 euro, të gjitha me kamatë ligjore. Gjykatës i ka propozuar të aprovojë të bazuar kërkesëpadinë e paditësve dhe të detyroj të paditurën në kompensimin e këtyre shumave. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar në pa i specifikuar.

E paditura me shkresën e datës 04.12.2023 ka parashtruar përgjigje në padi lidhur me të gjitha çështjet kontestuese sa i përket kërkesave: shpërblim jubilar, ushqim, udhëtim, kualifikim dhe inflacion, të cilat rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit e vitit 2017 dhe 2021 si dhe Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, nr.01/33 të datës 29.08.2008. Meqë objekt kontesti i kësaj çështje juridike është kompensimi i shpenzimeve të ushqimit dhe shpërblimit jubilar, gjykata vlerëson se kjo shkresë shërben si përgjigje në padi në lëndën konkrete. Kundërshtimet e të paditurës theksojnë se sa i përket kompensimit të shpenzimeve për udhëtim, të njëjtat nuk duhet të njihen nëse nuk argumentohen me prova përkatëse (certifikatë e vendbanimit, pagesë mujore në kompani transportuese, çmimi i biletës...). Sa i përket diferencës në pagë për shkak të kualifikimit, vendimi i qeverisë në fjalë është zbatuar sipas detyrës zyrtare posa ka hyrë në fuqi (me rastin e rritjes së pagave), andaj vendimi i njëjtë nuk mund të zbatohet dy herë. Sa i përket inflacionit, kjo e drejtë nuk i takon të punësuarve në sektorin e arsimit, pasi nuk mund të godet vetëm një sektor të punësimit, por të gjithë sektorët e aparatit shtetëror. Për të gjitha kërkesat, gjykatës i ka propozuar të vlerësojë parashkrimin e tyre, bazuar në nenin 87 të Ligjit të Punës dhe kërkesave periodike nga Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Gjykata pas pranimit të përgjigjes në padi ka konstatuar se janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seance gjyqësore, bazuar në nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), në të cilën është përcaktuar se “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritator, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë” dhe 399.1 që përcakton se “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në

padi nuk del themelësia e kërkesëpadiisë, atëherë ajo do te jep vendimin meritor me të cilën refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadiia”.

Gjykata ka gjetur se paditësja M.H. është e punësuar te e paditura për kohë të caktuar, për periudhën kohore 14.09.2020 – 31.08.2021 (kontrata e punës, nr.prot.19 e dt.14.09.2020), është mësimdhënëse e licencuar (licenca e mësimdhënësit nr.1029031 e dt.30.03.2021), ka diplomë të nivelit Bachelor nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Edukimit (diploma nr.1041 e dt.10.04.2018), ka pagën bazë prej 421.00 euro, ndërsa për kualifikim paguhet në shumën prej 58.32 euro (lista e pagës e lëshuar në emër të paditëses).

Paditësja B.G-R. është e punësuar te e paditura për kohë të caktuar, për periudhën kohore 01.09.2020 – 31.12.2020 (kontrata e punës, nr.prot.229 e dt.01.09.2020), është mësimdhënëse e licencuar (licenca e mësimdhënësit nr.1031203 e dt.04.07.2022), ka diplomë të nivelit Bachelor nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Edukimit (diploma nr.646 e dt.22.11.2014), ka pagën bazë prej 421.00 euro, ndërsa për kualifikim paguhet në shumën prej 58.32 euro (lista e pagës e lëshuar në emër të paditëses).

Paditësi H.H. është i punësuar te e paditura për kohë të caktuar, për periudhën kohore 18.01.2021 – 15.05.2021 (kontrata e punës, nr.prot.348 e dt.18.01.2021) dhe ka pagën bazë prej 421.00 euro (lista e pagës e lëshuar në emër të paditësit).

Nuk është kontestuese se përqindja e shkallës së inflacionit sipas entit të statistikave për vitin 2020 është 0.2 %, për vitin 2021 është 3.4 %, ndërsa për vitin 2022 është 11.6 % (fakt i provuar nga të dhënat e lëshuara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës).

Gjykata bazuar në nenin 329.1 të LPK-së, provat në shkresat e lëndës i gjeti vendimtare për vendosje në këtë çështje meritorë, pasi të njëjtat janë lëshuar nga organi shtetëror – këtu vet e paditura dhe Agjencia e Statistikave të Kosovës, brenda kufijve të kompetencës së vet, duke provuar saktësinë e thënieve në këto dokumente.

Gjykata vlerësoi se nuk ekzistojnë pengesa tjera për dhënien e vendimit meritor, pasi themelësia e kërkesëpadiisë, e aprovuar si në pikën I dhe jo themelësia e refuzuar si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi del bazuar në Vendimin e Qeverisë, Nr.01/33 të datës 29.08.2008 dhe në Kontratat Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017 dhe 22.01.2021.

Në Vendimin e Qeverisë, Nr.01/33 të datës 29.08.2008, i cili vendim ka qenë në fuqi deri më datë 06.02.2023 (i shfuqizuar me Ligjin për Pagat në Sektorin Publik, Nr.08/L-196), është përcaktuar se të gjithë mësimdhënësit do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit, pra mësimdhënësve, drejtorëve, zëvendës drejtorëve dhe bashkëpunorëve profesional, përfitojnë rritje page me diplomë të shkollës normale 10 % të pagës bazë, me diplomë të shkollës pedagogjike me nje ngritje te pagës bazë prej 19%, me diplome universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27% dhe me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35 %.

Zbatimi i këtij vendimi të Qeverisë, rastet e kualifikimit-licencimit është në përputhje edhe me Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, nr. 214/2023 të datës 05.10.2023.

Në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017 dhe 22.01.2021, në nenin 3, paragrafi 2 është përcaktuar se “I (e) punësuar do të thotë punëtor ose punëtore, i/e cili/cila ka lidhur marrëdhënie pune në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, Kontratës Kolektive në nivel të vendit dhe kësaj kontrate”; dhe nenin 35, paragrafi 10 se: “Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë”.

Dispozitat e Kontratave Kolektive të Arsimit për vitin 2017 aplikohen për periudhën 18.04.2017 – 21.01.2021 dhe për vitin 2021 aplikohen për periudhën 22.01.2021 – 21.11.2022, zbatimi i të cilave është në përputhje edhe me Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, nr.40/2023 të datës 27.02.2023 dhe nr.214/2023 të datës 05.10.2023.

Nga këto, gjykata vendosi si në pikën I dhe II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke ia aprovuar pjesërisht të bazuar kërkesëpadinë paditësve, pasi gjeti se kërkesa e paditësve është kërkuar më tepër sesa periudha e punësimi të tyre te e paditura.

Gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi ka gjetur se paditësit sa i përket periudhës së punësimit dhe asaj të kërkuar me petitumin e kërkesëpadisë nuk janë kompensuar për kualifikimin e tyre bachelor dhe shkallën e inflacionit sipas entit të statistikave të Kosovës, prandaj detyroi të paditurën në kompensimin e këtyre shpenzimeve.

Llogaritjen e të njëjtave e bëri sipas vlerës së pagës bazë dhe përqindjes sipas shkallës së kualifikimit dhe shkallës së inflacionit, ndërsa llogaritjen e bërë nga paditësit sipas vlerës së pagës bruto, gjykata ia refuzoi të pabazuar.

Në rastin konkret, gjykata ka gjetur se paditësit, të tre të punësuar në kohë të caktuar te e paditura, nuk kanë mbështetur kërkesën e tyre të kërkuar përtej periudhës së përcaktuar me kontratë të punësimit, prandaj gjykata pjesën tjetër të cilën nuk e kanë vërtetuar me prova konkrete, ia refuzoi të pabazuar, si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata vlerëson se është obligim i palëve në proces të mbështesin me prova konkrete faktet e tyre, e në këtë rast, në mungesë të provave bindëse për periudhën e saktë të punësimit të paditësve te e paditura, gjykata bazuar në nenin 7 të LPK-së, ia refuzoi pjesën tjetër për të cilën nuk vërtetohet kjo periudhë e punësimit.

Gjykata ka parasysh se në listën e pagës së paditësve figurojnë më shumë vite të punësimit, por të njëjtat nuk pasqyrojnë vendin e punës së tyre, prandaj u bazua në kontratat e sjellura nga të njëjtat të cilat gjenden në shkresat e lëndës.

Për kamatën, gjykata vendosi në bazë të nenit 382 të LMD-së.

Lidhur me pretendimin e të paditurës se Vendimi i Qeverisë është zbatuar sipas detyrës zyrtare, gjykata vlerëson se nuk qëndron ky pretendim pasi vendimi nuk është zbatuar në tërësi nga ana e të paditurës si punëdhënëse, përkatësisht të punësuarit janë paguar pjesërisht sipas kualifikimit të tyre, e jo mbi bazën e përqindjes siç e rregullon ky vendim. Edhe sa i përket pretendimit të të paditurës se inflacioni nuk mund të kërkohet vetëm në një sektor të punës, gjykata vlerëson se me kontratë kolektive është përcaktuar se inflacioni ka ndikim në pagën e mësimdhënësve – të punësuarve si në nenin 3.2 të KKAK-së, prandaj edhe këtë pretendim e gjeti të pabazuar.

Gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, bazuar në dispozitat ligjore nga neni 449, 452, 453 dhe 463 të LPK-së, meqë paditësit nuk i kërkuan shpenzimet e procedurës në mënyrë të specifikuar, ndërsa e paditura nuk i ka kërkuar fare shpenzimet procedurës.

Nga të lartëcekurat, bazuar në nenin 143, paragrafi 1 lidhur me nenin 398 dhe 399 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN  
Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil  
C.nr.2942/23, më datë 13.06.2024

Gjyqtarja,  
Erlinda Elezi-Tosku

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit në Gjykatën e Apelit, përmes këtij Gjykate.